



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME ELBASAN sha

Elbasan më: ____/ ____/ 2025

PROCESVERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE
DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Ndertim i ujesjellesit te fshatrave Polis-Sheh, Polis-Qender, Polis-Gurshpat Librazhd”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

(45247130-0 Punime ndertimi per ujesjellesa)

VLERA E FONDIT LIMIT:

225 154 725 (dyqind e njezet e pese milion e njeqind e pesedhjetë e kater mije e shtateqind e njezet e pese) Lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, të VKM nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Elbasan” sha**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, mbështetur në projektin dhe preventivin e miratuar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1. Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr.162/2020 “Për

Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19. 05. 2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 8.

Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale: Sipas kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare (2022, 2023, 2024) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e kontratës objekt prokurimi.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, në Ligjin Nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, si dhe nenin 43, nenin 55, pika 4 të VKM Nr. 285, datë 19. 05. 2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “*Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar*”, i ndryshuar,

ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Shënim: Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, në Ligjin Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në nenin 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 10091 datë 05. 03. 2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar mbi bazën e të cilave, autoriteti kontraktor mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi “të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28. 12. 1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30. 01. 2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Ligjin nr. 9920 datë 19. 05. 2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, me anë të dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.1.3 Operatorët Ekonomikë ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për këstet e maturuara të vitit 2025 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet me anë të paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse në DST, dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesi dhe fillimit të afateve të ankimimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, dhe në Ligjin nr. 9632, datë 30.10. 2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr. 9920 datë 19. 05.

2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe nenin 40 në Ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në Ligjin nr. 9723 datë 03. 05. 2007 “Për QKR” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

2.3.1. Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë 5 (pesë) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ose

b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë 5 (pesë) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomike do të kryhet bazuar në dokumentacionin e mëposhtëm:

Ne rast se punimet janë kryer me ente publike:

Operatori Ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, duhet të paraqesë formular vlerësimi lëshuar nga Investitori sipas Shtojcës 8 dhe situacion përfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

Ne rast se punimet janë kryer me sektorin privat:

Operatori Ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë vërtetime të shoqëruara me faturat tatimore të shitjes, ku të shënohen datat, shumat, natyra e punës së kryer dhe situacion përfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Pika 2.3.1 germa “a” plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 germa “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se Nr.285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar).

□ Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.

□ Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23. 12. 2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Gjithashtu referuar VKM-së nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu XI, Neni 88, pika 3 citohet se: “Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.” Autoriteti Kontraktor argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentet e kërkuara sipas pikave që vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Përvoja e suksesshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23. 12. 2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM-së Nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga

një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.

2.3.2 Operatorët Ekonomike duhet të dëshmojnë se disponojnë licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe për kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me *Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01. 2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*, i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Punime të përgjithshme ndërtimi :

NP-1	(Punime gjurmimi në tokë)	Klasifikimi B
N.P-4	(Rrugë, autostrada, mbikalime)	Klasifikimi A
NP-7	(Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje)	Klasifikimi D
NP-12	(Punime të inxhinierisë mjedisore)	Klasifikimi C

Punime speciale ndërtimi

NS-9	(Punime Strukturore Speciale)	Klasifikimi A
NS-14	(Impiante të brendshme, elektrik,)	Klasifikimi A
NS-18	(Punime topogjeodezike)	Klasifikimi C

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) në Republikën e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në Nr.42, datë 16. 01. 2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht s’kualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23. 12. 2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16. 01. 2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Referuar kategorive të kërkuara, autoriteti kontraktor argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.

Për sa më lart, me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për kategoritë e vendosura sipas volumeve të punimeve dhe vlerave që përmban Preventivi për çdo zë pune, mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16. 1. 2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku janë përcaktuar kategoritë dhe nënkategoritë përkatëse. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

2.3.3 Operatorët Ekonomikë duhet të kenë një punësim mesatar të paktën **79** (shtatëdhjetë e nente) personave të siguruar për periudhën e tre muajve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

Për këtë ofertuesi duhet të paraqesë:

a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin nga muajt e kërkuar;

b) Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet me anë të paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse në DST, dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimit.

Argumentimi: Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialistë i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, afati i realizimit të kontratës, orët e punës etj. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje për të paktën tre muajt e fundit nga data e hapjes së procedurës, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën me sukses.

Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit i parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listë-pagesat me këtë kohështirje, është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomikë si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. Numri i punonjësve që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10. 09. 1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe në zbatim të akteve nënligjore.

Nga ana teknike argumentojmë se numri prej 79 punonjës në total (ku janë përfshirë Drejtorët Teknikë, Ing. Mbështetës, punonjësit e specialiteteve të ndryshme për punimet përkatëse, shoferë, manovratorë), është caktuar në bazë të llogaritjeve (zbërthimit) të zërave të punës dhe volumit përkatës të çdo zëri në analizat teknike si dhe grafikut në zbatim të punimeve, të cilat duhet të përfundojnë për jo më shumë se 18 (tetëmbëdhjetë) muaj nga data e procesverbalit të lirimit (dorëzimit) të sheshit të ndërtimit. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë afatin e zbatimit në grafikun e punimeve si dhe orët total të punës për secilin zë punimesh në kontratës që prokurohet.

Nëpërmjet këtij kushti kërkohej që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të t’i dhënë garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listë-pagesat e punonjësve, mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, sipas së cilës: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

2.3.4 Operatorët Ekonomikë duhet të kenë pjesë të stafit teknik të shoqërisë si Drejtues Teknik në Licensën e kompanisë Inxhinierët si më poshtë:

Inxhinier Mjedisi	1 (një)
Inxhinier Ndertimi	1 (një)
Inxhinier Gjeodet	2 (dy)
Inxhinier Hidroteknik	2 (dy)
Inxhinier Gjeolog	1 (një)
Inxhinier Mekanik	1 (një)
Inxhinier Ndërtimi Profili Gjeoteknik	1 (një)
Inxhinier Elektronik	1 (një)

- Për stafin e mësipërm Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kontratë pune e vlefshme,
- b) Diploma Universitare si dhe të figurojnë në listë-pagesat e kompanisë, minimalisht për periudhën e tre muajve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet me anë të paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit nga operatorët ekonomikë, sipas shtojcës përkatëse në DST, dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimimit.

Argumentimi: Autoriteti Kontraktor argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23. 12. 2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, elektrik, mjedisi, mekanik, hidroteknik, topograf/marksheider, gjeolog, etj., është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të pasur rezultatin e kërkuar në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Drejtuksi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij drejtues teknik të cilët kanë një rol specifik në mbarëvajtjen e punimeve, pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij gjithashtu këta drejtues teknik plotësojnë kërkesat e fushave të zbatimit sipas profilit përkatës.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të natyrës së punimeve që i është bërë projektit të zbatimit të Punimeve (ku përcaktohet dhe profili inxhinierik), si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2.3.2, kapaciteti teknik në DST.

Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve, rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar sipas pikës 2.3.4., të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin, stafin mbështetës si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.3.5 Krahës stafit teknik Operatorët Ekonomike duhet të kenë të punësuar staf mbështetës si me poshtë:

• Ing. Ndërtimi	1 (një)
• Ing. Elektrik	1 (një)
• Ing. Hidroteknik	1 (një)
• Teknik Ndërtimi	2 (dy)
• Teknik Topograf	1 (një)
• Karpentier	6 (gjashtë)
• Specialist Guri/Gurë-punues	2 (dy)
• Murator	2 (dy)
• Saldator	3 (tre)
• Hekurkthyes	4 (kater)
• Specialist Ndërtimi	4 (kater)
• Specialist për montim tubash	4 (kater)
• Hidraulike	10 (dhjetë)
• Hidroizolues	2 (dy)
• Elektricitist	2 (dy)
• Pllakashtrues	2 (dy)
• Bojaxhi	2 (dy)
• Punonjës të konstruksioneve metalike	2 (dy)
• Specialist Dyer Dritare	2 (dy)
• Shoferë	4 (katër)
• Punëtori e thjeshtë	5 (pese)
• Automakinistë	2 (dy)
• Manovrator	4 (katër)
• Buldozieristë	1 (një)

Për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë :

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr. NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1				
2				
Etj.				

- Kontratat e punës individuale (të vlefshme).
- Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH.”, i ndryshuar.
- Të gjithë punonjësit e mësipërm duhet të figurojnë në listë-pagesat e shoqërisë, minimalisht për periudhën e tre muajve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit.
- Për Teknikun e Ndërtimit, Teknikun Topograf , duhet të paraqitet dëftesë e shkollës së mesme.

Për Manovrator/automakinistë/shoferë/buldozeristë, të paraqitet kontrata e punës dhe dëshmia e aftësisë profesionale lëshuar nga DPSHTRR. Në rastin kur punonjësit e mësipërm janë të kontraktuar me kontratë pune respektivisht për mjetet e marra me qira nga persona fizikë, nuk kërkohet të figurojnë në listë-pagesat e shoqërisë.

Dokumentacioni (Diplomat/dëshmitë/certifikatat) që nuk janë lëshuar sipas legjislacionit përkatës të arsimit profesional, do të konsiderohen jo të sakta dhe bëhen shkak për veprime të mëtejshme sipas parashikimeve përkatëse të ligjit të prokurimit publik.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet me anë të paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit nga operatorët ekonomikë, sipas shtojcës përkatëse në DST, dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23. 12. 2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me ligjin nr 16/2024 dhe nenit 39, pika 6/c, të VKM-së nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë një listë personeli kryesor të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorëve ekonomikë për të përmbushur kontratën me sukses.

Për të përcaktuar stafin teknik të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 216, date 13. 04. 2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, bazuar në përllogaritjen e orëve të punës, kategoritë e punimeve të përcaktuara në preventiv dhe në specifikimet teknike të objektit, detajeve të projektit dhe tipologjia e zërave të punimeve, të cilat lidhen ngushtësisht me listën e stafit teknik të kërkuar nga AK, si edhe bazuar në domosdoshmërinë e realizimit sa më shpejt të objektit.

Inxhinier Mjedisi 1 (një)

Inxhinier Ndertimi	1 (një)
Inxhinier Gjeodet 2 (dy)	
Inxhinier Hidroteknik	2 (dy)
Inxhinier Gjeolog 1 (një)	
Inxhinier Mekanik	1 (një)
Inxhinier Ndërtimi Profili Gjeoteknik	1 (një)
Inxhinier Elektronik	1 (një)

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të projektit të zbatimit punimeve.

- Inxhinieri i Ndërtimit është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar preventivit në proceset e punës. Ky inxhinier ka për detyrë menaxhimin e zbatimit të punimeve ndërtimore, analizimin e projektit pasi kemi të bëjmë me punime ndërtimi apo rikonstruksioni, ndjekjen e ecurisë së punimeve në kantier gjithashtu plotësimin e dokumentacionit përkatës për dosjen e zbatimit;

- Inxhinieri Elektrik është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve , referuar preventivit të instalimeve elektrike si dhe në proceset e punës gjithashtu plotësimin e dokumentacionit përkatës për dosjen e zbatimit.

- Inxhinieri i Mjedisit është përgjegjës për mbarëvajtjen e të gjitha punimeve dhe sigurimin që punimet e kryera, të mos cenojnë kushtet dhe parametrat mjedisore të terrenit, dhe të kenë ndikim sa më të vogël në mjedis.

- Inxhinieri Mekanik është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve, referuar projektit të zbatimit si dhe ndjekjen e anës teknike të makineri pajisje në objekt.

- Inxhinieri Hidroteknik është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve, referuar zërave hidroteknike dhe instalimeve”, etj. Ky inxhinier është përgjegjës për shtrimin e linjave të ujësjellësit, vendosjen e matësve të ujit të pijshëm, rakorderive, etj., ku është e nevojshme që punimet të zbatohen dhe kontrollohen në mënyrë konkrete nga ana e inxhinierit me profilin e duhur gjithashtu plotësimin e dokumentacionit përkatës për dosjen e zbatimit;

- Inxhinieri Gjeodet/ Topograf/ Markshajder është përgjegjës për kryerjen e azhurnimit topografik dhe piketimin e objektit , si dhe do të ndjekë punimet e zbatimit sipas kuotave të projektit. Gjithashtu pas përfundimit të punimeve do të bëjë edhe azhurnimin faktit . Ky inxhinier është i nevojshëm për dhënien dhe vendosjen në terren të kuotave të nevojshme mbi dhe nën tokësore, gjatë zbatimit të punimeve të objektit deri në përfundimin e plotë të tij në përputhje me kuotat e përcaktuara në projektin e zbatimit të objektit gjithashtu plotësimin e dokumentacionit përkatës për dosjen e zbatimit.

- Inxhinieri Gjeolog është përgjegjës për punimet e verifikimeve të tabanit/tabaneve në të cilët do të ndërtohen strukturat, apo do të ketë shpime me qëllim realizimi e punimeve , si dhe mbarëvajtjen e tyre sipas Kushteve Teknike

dhe kontrollin e gjeologjisë nëse është apo jo e përshtatshme për kryerjen e këtyre punimeve.

2.3.6 Operatorët Ekonomike duhet të kenë në stafin teknik ose mbështetës, të certifikuar të paktën:

2.3.6/a -1 (një) punonjës të pajisur me certifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 10237, date 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, date 05. 05. 2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

Për të përmbushur këtë kriter, OE duhet të paraqesin kontratë pune, diplomë dhe certifikatën përkatëse si dhe duhet të jetë në listë-pagesat e shoqërisë, të paktën për periudhën e tre muajve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

2.3.6/b Operatorët ekonomikë, për të siguruar shërbimin mjekësor në shoqëri, duhet të kenë të punësuar një mjek të përgjithshëm ose të kenë të kontraktuar nga jashtë këtë shërbim. Në rastin kur mjeku është i punësuar në shoqëri, duhet të paraqitet një kontratë pune e vlefshme, licensë për ushtrimin individual të profesionit, diplomë. Në rast se mjeku është i punësuar në shoqëri, duhet të figurojë në listë-pagesat e shoqërisë për periudhën e të paktën tre muajve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

Në rastin kur mjeku është kontraktuar nga jashtë, do të paraqitet kontrata për këtë shërbim, licensa përkatëse, si dhe fatura e këtij shërbimi, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” ndryshuar me vendimin nr. 632, datë 15.7.2015).

2.3.6/c Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë 1 (një) punonjës i cili të jetë i pajisur me certifikatë “Ekspert Zjarrfikës” në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, Neni 49, pika 4, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/certifikatë, Librezë pune, si dhe të figurojë në listë-pagesat e shoqërisë për periudhën e të paktën tre muajve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit ose eksperti zjarrfikës mund të sigurohet nga operatori ekonomik edhe me anë të marrëdhënies kontraktore për ekzekutimin e kontratës objekt prokurimi. Në rastin kur eksperti zjarrfikës mund të sigurohet nga operatori ekonomik edhe me anë të marrëdhënies kontraktore do të paraqitet kontrata për këtë shërbim, certifikata përkatëse, si dhe fatura e këtij shërbimi.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet me anë të paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit nga operatorët ekonomikë, sipas shtojcës përkatëse në DST, dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimimit.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23. 12. 2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Gjithashtu kërkesa e mësipërme mbështetet në

ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05. 05. 2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Operatorët ekonomikë, për të siguruar shërbimin mjekësor në shoqëri, duhet të kenë të punësuar një mjek të përgjithshëm ose të kenë të kontraktuar nga jashtë këtë shërbim. Në rastin kur mjeku është i punësuar në shoqëri, duhet të paraqitet një kontratë pune e vlefshme, licensë për ushtrimin individual të profesionit, diplomë. Në rast se mjeku është i punësuar në shoqëri, duhet të figurojë në listë-pagesat e shoqërisë për periudhën e të paktën tre muajve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

Në rastin kur mjeku është kontraktuar nga jashtë, do të paraqitet kontrata për këtë shërbim, licensa përkatëse, si dhe fatura e këtij shërbimi, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” ndryshuar me vendimin nr. 632, datë 15.7.2015).

Në lidhje me kërkesën për disponimin e 1 (një) specialisti Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, njësia e prokurimit vlerëson se, kjo kërkesë është në përputhje me kontratën objekt prokurimi, pasi stafi operacional i operatorit ekonomik duhet të jetë i trajnuar për çdo rast emergjence, ku ndër to janë edhe rastet e zjarrit, kërkesë kjo bazuar në parashikimet e nenit 38 të Ligjit Nr. 152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, në të cilin përcaktohet se, personat fizikë dhe juridikë zbatojnë dispozitat e parashikuara nga ky ligj dhe akte të tjera nënligjore, në lidhje me marrjen e masave për parandalimin e pakësimit e zjarreve, me anë të mjeteve, sistemeve, pajisjeve të diktimit- sinjalizimit për shuarjen e zjarreve, gjatë kryerjes së aktivitetit të tyre.

2.3.7 Operatorët Ekonomike duhet të disponojë mjetet e mëposhtme:

Nr.	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 20 ton	në pronësi ose me qira	copë	2
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-14 ton	në pronësi ose me qira	copë	3
3	Kamionçinë me kapacitet mbajtës nga 1.5 deri në 2 ton	në pronësi ose me qira	copë	3
4	Kamionçinë me kapacitet mbajtës nga 3.5 deri në 5 ton	në pronësi ose me qira	copë	3
5	Ekskavator me goma (mjet teknologjik me goma)	në pronësi ose me qira	copë	3
6	Minifadromë (mjet teknologjik me goma)	në pronësi ose me qira	copë	2
7	Fadromë me goma (mjet teknologjik me goma)	në pronësi ose me qira	copë	1

8	Jelekë fosforeshentë	në pronësi ose me qira	copë	79
9	MiniDamper (mjet teknologjik me goma)	në pronësi ose me qira	copë	3
10	Kamion me vinç	në pronësi ose me qira	copë	2
11	Rimorkiator	në pronësi ose me qira	copë	2
12	Autobot Uji	në pronësi ose me qira	cope	2
13	Autobetoniere	në pronësi ose me qira	copë	3
14	Eskavator me zinxhir cekic	në pronësi ose me qira	copë	1
15	Autopompë Betoni	në pronësi ose me qira	copë	2
16	Vibrator Betoni	në pronësi ose me qira	copë	4
17	Autobetonjerë me kapacitet 2.5 - 3.5 m ³ (mjet teknologjik me goma)	në pronësi ose me qira	copë	2
18	GPS	në pronësi ose me qira	copë	1
19	Kontenier Stacioner (zyra, ndërresa)	në pronësi ose me qira	copë	1
20	Buldozer	në pronësi ose me qira	copë	1
21	Kokë tërheqëse	në pronësi ose me qira	copë	2
22	Betoforma	në pronësi ose me qira	m ²	400
23	Kokore	në pronësi ose me qira	copë	79
24	Aparaturë për bashkim tubacionesh me metodën “Elektro Fusion”	në pronësi ose me qira	copë	3
25	Aparature për bashkim tubacionesh me metodën “kokë më kokë”	në pronësi ose me qira	copë	1
26	Detektor per linja Elektrike	në pronësi ose me qira	copë	1
27	Elektrosaldatrice	në pronësi ose me qira	copë	2
28	Skeleri	në pronësi ose me qira	M2	400
29	Motosaldatrice	në pronësi ose me qira	copë	1
30	Gjenerator	në pronësi ose me qira	copë	1

Për të dëshmuar këtë, Formulari i shtojcës të DST-ve, duhet të shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:

- **Për mjetet që shënohen në regjistra publikë**, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit: - certifikatën e pronësisë; -leja e qarkullimit; -certifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin; - leja e transportit, si dhe të paraqesë foto të qartë për secilin mjet dhe të jetë e dukshme targa e mjetit.
- Për mjete të marra me qira/kontratë bashkëpunimi krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata noteriale e qirasë
- **Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë**, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo zhdoganimit, fotot dhe fatura tatimore përkatëse, ndërsa për mjete të marra me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet me anë të paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit nga operatorët ekonomikë, sipas shtojcës përkatëse në DST, dhe

dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimimit.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23. 12. 2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronësi /qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe volumeve të punës në projekt, duke iu referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekteve. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës.

Nr.	Lloji i makinerive	Argumentimi
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 20 ton	Eshtë i nevojshëm për transportin e materialeve të ndryshme
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-14 ton	Eshtë i nevojshëm për transportin e materialeve të ndryshme në vendet ku nuk futet kamioni mbi 20ton
3	Kamionçinë me kapacitet mbajtës nga 1.5 deri në 2 ton	Eshtë i nevojshëm për transportin e materialeve të ndryshme aty ku nuk futetn kamionet e medhenj
4	Kamionçinë me kapacitet mbajtës nga 3.5 deri në 5 ton	Eshtë i nevojshëm për transportin e materialeve të ndryshme aty ku nuk futetn kamionet e medhenj
5	Ekskavator me goma (mjet teknologjik me goma)	Eshtë i nevojshëm për gërmimie të ndryshme si kanale, apo bazamente
6	Minifadromë (mjet teknologjik me goma)	Eshtë i nevojshëm për ngarkimin e kamioneve, kamioncinave, minidumper, hapje materiali në rrugë etj
7	Fadromë me goma (mjet teknologjik me goma)	Eshtë i nevojshëm për hapje materiali dhe ngarkim kamioni mbi 20t
8	Jelekë fosforeshentë	Eshtë i nevojshëm si kusht për sigurimin e punetoreve

9	MiniDamper (mjet teknologjik me goma)	Eshte i nevojshem per transportin e materialeve te ndryshme nga vendi i blerjes deri ne kantier, apo per transportin e materialeve te nxjerra nga prishjet apo germimet deri ne vendin e percaktuar nga bashkia per tu hedhur.
10	Kamion me vinç	Eshte i nevojshem per ngritjen dhe shkarkimin e paletave me cemento, tubo, rakorderi etj
11	Rimorkiator	Eshte i nevojshem per transportin e makinerive jo vetlevizese ne rruge automobilistike
12	Autobot Uji	Eshte i nevojshem per te patur uje ne objekt dhe per te bere lagien e rrugeve per mos te pasur pluhura gjate punimeve
13	Autobetoniere	Eshte i nevojshem per transportin e betonit
14	Rul vibrues Gomë-Hekur me kapacitet mbi 10 ton	Eshte i nevojshem per ngjeshjen e shtresave
15	Autopompë Betoni	Eshte i nevojshem per hedhjen e betonit
16	Vibrator Betoni	Eshte i nevojshem per vibrimin e betonit
17	Autobetonjerë me kapacitet 2.5 - 3.5 m ³ (mjet teknologjik me goma)	Eshte i nevojshem per marrjen e materialeve si zhavorr, cakell, cemento, pergatitje betoni , dhe transport betoni ne vendet ku nuk ka akses pompa dhe betonieret e medha.
18	GPS	Eshte i nevojshem per marrjen e kuotave te ndryshme
19	Kontenier Stacioner (zyra, ndërresa)	Eshte i nevojshem per te pasur zyre ne objekt per stafin
20	Buldozer	Eshte i nevojshem per shtytjen e materialeve
21	Kokë tërheqëse	Eshte i nevojshem per terheqjen e rimorkiatorit
22	Betoforma	Eshte i nevojshem per te bere armaturat per punime betonimi
23	Kokore	Eshte i nevojshem per masa mbrojtese pe punetoret
24	Aparaturë për bashkim tubacionesh me metodën “Elektro Fusion”	Eshte i nevojshem per bashkimin e tubave
25	Aparature për bashkim tubacionesh me metodën “kokë më kokë”	Eshte i nevojshem per bashkimin e tubave
26	Detektor per linja Elektrike	Eshte i nevojshem per detektimin e linjave gjate germimeve.
27	Elektrosaldatrice	E nevojshme per saldimin e tubave dhe profilave metalike

28	Skeleri	E nevojshme per realizimin e soletave, trare, mure betonie etj
29	Motosaldatrice	E nevojshme per saldimin e tubave dhe profilave metalike ne vendet ku nuk ka energji elektrike
30	Gjenerator	Per te patur energji elektrike ne kantier

Argumentimi për dokumentacionin e kërkuar për mjetet: “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, në nenin 92 parashikon shprehimisht se: “Automjetet, motomjetet dhe rimorkiot për të qarkulluar duhet të jenë të pajisura me një leje qarkullimi dhe të jenë të regjistruara pranë degëve përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor”.

-“Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 79/3 parashikon shprehimisht se “Të gjitha mjetet që qarkullojnë dhe hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë janë të detyruara të kalojnë në kontroll teknik...”

-Ligji nr. 10076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” neni 4 parashikon shprehimisht se: “Pronari i çdo mjeti transporti, përpara përdorimit të mjetit, është i detyruar të lidhë një kontratë sigurimi, sipas pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji, si dhe të sigurojë rinovimin e saj për atë kohë sa mjeti i transportit do të mbetet në qarkullim..”.

-Ligji nr.8308 datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” neni 5 parashikon shprehimisht se :

“Veprimtaria e transportit rrugor për udhëtarë dhe mallra për të tretë dhe me qira, kryhet mbi bazën e licencës...”Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

2.3.8Operatorët ekonomikë ofertues duhet të jenë të pajisur me:

- Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III. 2. B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve të ngurta, inerte”, mbështetur në Ligjin Nr. 9010, datë 13. 02. 2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” (Ndryshuar me Ligjin Nr. 10137, datë 11. 05. 2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”), së bashku me aktin e miratimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të Ligjit nr. 162, datë 23. 12. 2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Po ashtu, referuar preventivit të punimeve, duke qenë se në kontratën objekt prokurimi kemi kryerjen e punimeve të gërmimeve (dheu, kanale), prishje struktura dhe shtresa rrugore, dhe kryerjen e transportit të tyre në vend-depozitim, bazuar në përcaktimet e nenit 21, 37 e 57 të Ligjit nr. 10 463, datë 22. 09. 2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 575, datë 24. 06. 2015 “Për

miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte” ku transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve, ndaj operatorët ekonomik duhet të jenë të licencuar për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të llojeve të ndryshme (Kodi III.2.B) sipas Ligjit nr. 10 081, datë 23. 02. 2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, nga institucioni kompetent që lëshon këto licenca (Qendra Kombëtare e Licencimit), në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr. 538, datë 26. 05. 2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi, qira ose kontratë bashkëpunimi, impiantet si më poshtë:

a. 1 (një) Impiant prodhimi Inerte

b. 1 (një) Impiant prodhimi Betoni

Për impiantin e prodhimit të inerteve/betonit, në rast se është në pronësi, duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë e tij.

Në rast se impianti i prodhimit të inerteve/betonit, është me qira ose kontratë bashkëpunimi, duhet të paraqitet kontrata e qirasë/bashkëpunimit, e vlefshme për periudhën e zbatimit të punimeve.

Argumentimi: Për garantimin e cilësisë dhe furnizimit në kohë sipas të gjitha specifikimeve që janë kërkuar nga autoriteti kontraktor.

2.3.10 Operatorët Ekonomikë ofertues, duhet të jenë të certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- Certifikatën e menaxhimit të cilësisë **ISO 9001:2015** (të vlefshme, ose ekuivalente), e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën **ISO 9001:2015**, të vlefshme, ose ekuivalente) ne raport me punimet qe ka marre persiper te realizoje.
- Certifikatën e menaxhimit të mjedisit **ISO 14001-2015** (të vlefshme, ose ekuivalente), e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën **ISO 14001-2015** (të vlefshme, ose ekuivalente) ne raport me punimet qe ka marre persiper te realizoje.
- Certifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit **ISO 45001-2018**, (të vlefshme, ose ekuivalente), e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e

Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën **ISO 45001-2018** (të vlefshme, ose ekuivalente) ne raport me punimet qe ka marre persiper te realizoje.

- Certifikatën e menaxhimit të cilësisë në Saldim **EN-ISO 3834-2:2021** (të vlefshme,ose ekuivalente), e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën **EN-ISO 3834-2:2021** (të vlefshme, ose ekuivalente) ne raport me punimet qe ka marre persiper te realizoje.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur për të vërtetuar pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, standardet për shëndetin dhe sigurinë në punë standardet e menaxhimit të mjedisit. Ky kriter është përcaktuar bazuar në nenin 79, të Ligjit nr. 162, datë 23.12. 2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 44, të VKM nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standardet e kërkuara të cilësisë dhe standardet për shëndetin dhe sigurinë në punë si dhe standardet e menaxhimit të mjedisit.

Është e nevojshme pasi një seri normash dhe standardizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standardet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me certifikatat ISO të mësipërme me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulëta.

2.3.11 OE, duhet të kenë kontratë noteriale me një laborator të akredituar ku të jetë përcaktuar objekti i kontratës/procedurës, për kryerjen e testimeve gjatë fazës së zbatimit si dhe përfundimit të objektit. Laboratori duhet të jetë i akredituar për testet e poshtë shënuar, të certifikuar në përputhje me S SH ISO/ICE 17025:2017:

- përbërja e përzierjes së betonit/formula e mix design.
- përcaktimi i konsistencës së betonit nëpërmjet testit slump.
- përcaktimi në shtypje i mostrave të testimit.
- metoda e kryerjes së provave pa shkatërrim të betonit – përcaktimi i shpejtësisë ultrasonik.
- metodikat e kryerjes së provave pa shkatërrim të shtresave rrugore – metoda e testimit për përcaktimin e deformimeve me pajisjen Falling-Weight-Type Impulse Load Device.
- metoda standard për testimin në tërësi të themeleve të thellë të betonit, me metodën ultrasonic cross hole.
- metoda e provës standard për testimin e integritetit të themeleve të thellë,

nëpërmjet impaktit të tensionit të ulët.

- përcaktimi i pikës së zbutjes.
- përcaktimi i densitetit vëllimor të mostrave të ngjeshura bituminoze.
- kontrolli i përmasave.
- rezistenca në tërheqje: σ_{rr} , σ_k .
- përcaktimi i densitetit të korpusit.
- përcaktimi i shpërndarjes granulometrike.
- përcaktimi i treguesit të aftësisë mbajtëse (CBR).

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të Ligjit nr. 162, datë 23. 12. 2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 3 të VKM nr.285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në rëndësinë e veprës, e cila është komplekse dhe e lidhur drejtpërdrejtë me popullatën dhe mjedisin përreth. Materialet e përdorura, duhet të plotësojnë kushtet minimale sipas standardeve, të cilat duhet të kalojnë disa teste laboratorike që të plotësojnë këto kërkesa.

2.3.12 Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin Grafikon e punimeve sipas të gjithë zërave të preventivit dhe afateve të parashikuara nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të Ligjit nr. 162, datë 23. 12. 2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në nenin 39, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Gjithashtu në nenin 15 pika 3/a të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku ndër të tjera parashikohet se: “a) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën: - grafikun e zbatimit;”

2.3.13 Operatorët Ekonomikë, në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivin përkatës të publikuar në DST, për materialet si më poshtë:

- a) Turbo Ujësjellësi
- b) Elektropompa
- c) Hekur
- ç) Rakorderi Ujësjellësi
- d) Materiale elektrike,

duhet të paraqesin:

1. Autorizim të Prodhuesit/ve ose autorizim nga Distributori i Autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje Bashkëpunimi të zyrtarizuar, ku të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi/Marrëveshja e Bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, website, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është vendosur sipas pikës 4, paragrafi 1, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23. 12. 2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar. Kjo kërkesë është vendosur për të garantuar autoritetin kontraktor se operatori ekonomik i ka kapacitet për të ofruar furnizim të vazhdueshëm me materialet e nevojshme për kryerjen e punimeve sipas zërave të preventivit.

Paraqitja e këtyre dokumenteve është vlerësuar nga Autoriteti kontraktor se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkesat e standardeve në lidhje me garantimin e cilësisë së punimeve objekt kontrate në mënyrë të qëndrueshme, ku referuar natyrës së punimeve që kërkohen të kryhen, certifikatat e mësipërme shërbejnë për vërtetimin se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto punime. Kjo referuar nenit 40 pika 6 të VKM-së Nr. 285 datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, duhet që këto materiale e pajisje të plotësojnë parametrat dhe standardet e kërkuara në specifikimet teknike e përcaktuara në objektin e kontratës, ku për vërtetimin e përmbushjes së tyre, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: Autorizim prodhuesi ose distributorin, katalogët ose pjesë të tyre, dëshmitë e testimeve të kryera ose ISO, me qëllim realizimin me sukses të kontratës.

Gjithashtu, përveç vendosjes është parashikuar dhe furnizimi i materialeve, referuar natyrës së tyre, ku duhet të jenë të një cilësie të mirë, referuar kostos së tyre dhe funksionit që kanë, me qëllim që të kenë jetëgjatësi përtej periudhës së garancisë që kanë, vlerëson se operatorët ekonomik duhet të paraqesin dokumentacionin që vërteton lidhjen me prodhuesin ose distributorin e autorizuar nga do t’i sigurojnë këto materiale objekt kontrate, katalogët e pajisjeve/materialeve si dhe dokumentacionin me të dhënat e këtyre materialeve, me qëllim verifikimin/vlerësimin nga A.K, nëse këto materiale/pajisje për të cilat do të ofertojnë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, janë në përputhje me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara në dokumentet e tenderit, si dhe janë të prodhuara nga prodhues të certifikuar për prodhimin e tyre me cilësi dhe brenda standardeve të miratuara.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Njësia e Prokurimit